



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2004/04

Prishtinë, më 19 shkurt 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet **HYSENI**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për transportin e mallërave të rrezikshëm;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për barazi gjinore;
6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit kundër diskriminimit;
7. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për shëndetësi;
8. Shqyrtimi i dytë i P/legjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës;
9. Shqyrtimi i veprimt të strukturave paralele në Kosovë dhe
10. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Në fillim të seancës, **kryetari** kërkoi që P/ligji për Odën Ekonomike të Kosovës të hiqet nga rendi i ditës, ngase amendamentet e propozuara për këtë p/ligj janë në kundërshtim njëri me tjetrin. Nëse Kuvendi i miraton amendamentet e propozuara, atëherë Ligji bëhet i pazbatueshëm. Ai kërkoi që Komisioni Legjislativ të deklarohet për amendamentet e propozuara në këtë p/ligj se a priset struktura dhe koncepti i këtij p/ligji.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e përkrahu propozimin e kryetarit për shtyerjen e shqyrtimit të p/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës. Ai kërkoi që Komisioni Legjislativ ta interpretojë mënyrën e votimit në seanca plenare, sipas normave pozitive dhe në seancën e ardhshme, t'ia paraqesë mendimin Kuvendit.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e përkrahu propozimin e kryetarit për shtyerjen e shqyrtimit të P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës. Ai shprehu pakënaqësi me radhitjen e ulësve të deputetëve në sallën e seancave plenare dhe kërkoi nga Kryesia ta zgjidhë këtë çështje, përkatësisht të bëjë radhitjen e ulësve siç ishin mëherët dhe çdo deputet të ketë emrin e vet para ulësve të tij.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e përkrahu propozimin e kryetarit për shtyerjen e shqyrtimit të p/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës dhe të Sabri Hamitit që Komisioni Legjislativ ta interpretojë mënyrën e votimit në seanca plenare.

Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të komuniteteve të tjera, e përkrahu propozimin e kryetarit për shtyerjen e shqyrtimit të p/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës.

Pas këtyre diskutimeve, **Kuvendi** nxori këto:

Përfundime

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës shtyhet për seancën e ardhshme plenare.
2. Ngarkohet Komisioni Legjislativ të deklarohej lidhur me amendamentet e propozuara në P/ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës.
3. Ngarkohet Komisioni Legjislativ ta interpretojë mënyrën e votimit në seanca plenare, sipas akteve pozitive.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për transportin e mallërave të rrezikshëm.

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Zef Morina e paraqiti materien që e normon ky p/ligj, objektivat që synohen të realizohen me të, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të P/ligjit nga ministri **Zef Morina**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij p/ligji në parim

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me P/ligjin për transportin e mallrave të rrezikshmëm i dhanë këta deputetë: Mahir Jakxhillar, Bajrush Xhemajli, Ramadan Kelmendi, Naim Maloku, Blerim Baruti, Ibush Jonuzi, Agim Krasniqi, Muhamed Kelmendi, Halil Ahmeti dhe Sabit Rrustemi.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij p/ligji dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----75;

Kundër-----0;

Abstenime---0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për transportin e mallërave të rrezikshëm dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për materialin fidanor.

Meqë propozuesi nuk ishte i pranishëm në seancë për ta arsyetuar P/ligjin para deputetëve të Kuvendit, shqyrtimi i tij u shtye për seancën tjetër.

4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për barazi gjinore.

Kryetari i informoi deputetët për proceduar e shqyrtimit të këtij p/ligji si dhe për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional. Ai i hodhi në votë amendamentet e propozuara në këtë p/ligj, veç e veç.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 1, 3, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37 dhe 38.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e katërt.

Në fund, **kryetari** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----1;

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për barazi gjinore.

Pas miratimit të këtij Ligji, **kryetari** dha një pauzë njëorëshe.

Pas pauzës seancën e drejtoi **Hydajet Hyseni**, anëtar i Kryesisë.

5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit kundër diskriminimit.

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë p/ligj.

Arsim Bajrami, në emër të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese-si Komision FunkSIONAL, i arsyetoi amendamente e paraqitura në këtë p/ligj dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratonin.

Kryesuesi i hodhi në votë, veç e veç amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, dhe 8.

Në fund, **kryesuesi** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----70;
Kundër----0;
Abstenime-0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin kundër diskriminimit.

6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për shëndetësi.

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit FunkSIONAL në këtë p/ligj.

Sabri Hamiti kërkoi që Kuvendi t'i votojë përnjëherë të gjitha amendamentet e propozuara në këtë p/ligj.

Nafije Gash, në emër të Komisionit FunkSIONAL, i arsyetoi amendamentet e paraqitura në këtë p/ligj dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratonin ato. Ajo e përkrahu propozimin e Sabri Hamitit që amendamentet të votohen në pako.

Kryesuesi theksoi se sipas Rregullorës të punës së Kuvendit, amendamentet e propozuara duhet të votohet veç e veç. Ai i hodhi në votë amendamentet e propozuara në këtë p/ligj, veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto

amendamente:1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,23,24,25,26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49,50,51,52,53,54,55,56,57,58(amendamenti 59 duhet të riformulohet)
60,61,62,63,64,65,66,67,68,69,70,71,72,73,74,75,76,77,78,79,80,
81,82,83,84,85,86,87,88,89,90,91,92,93,94,95,96,97,98,99 dhe 100.

Në fund,**kryesuesi** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----71;
Kundër-----0;
Abstenime—0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës,njëzëri,e miratoi Ligjin për shëndetësi.

7. Shqyrtimi i dytë i P/legjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës.

Kryesuesi i informoi deputetët për raportet dhe për rekomandimet e paraqitura nga komisionet kryesore dhe nga Komisioni FunkSIONAL në këtë p/ligj.

Arsim Bajrami,në emër të Komisionit FunkSIONAL,i arsyetoi amendamentet e paraqituara në këtë p/ligj dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratonin ato.

Bujar Dugolli i arsyetoi amendamentet që i kishte paraqitur në këtë p/ligj dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratonin ato.

Kryesuesi i hodhi në votë amendamentet e Komisionit FunkSIONAL,të Bujar Dugollit dhe të koalicionit "Kthimi",veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente:1,2,9,10,13 dhe 14.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet : 3,4,5,6,7,8,11 dhe 12.

Në fund,**kryesuesi** e hodhi në votë P/ligjin në tërësi dhe rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----shumica;
Kundër-----3;
Abstenime----11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës,me shumicë votash,e miratoi Ligjin për bashkëpunim me Tribunalin Penal të Hagës.

7. Shqyrtimi i veprimit të strukturave paralele në Kosovë.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e kësaj nisme ta marrë fjalën lidhur me shqyrtimin e kësaj çështje.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, theksoi se territori i Kosovës, sipas kreut 1, pika 1 dhe 2 është i pandashëm dhe Instucionet e Vetëqeverisjes së Pëkohshme të Kosovës dhe UNMIK-u duhet t'i ushtrojnë përgjegjësit e tyre, por ky përcaktim nuk po zbatohet në një të tretën e territorit të Kosovës.

Strukturat paralele serbe, të përkrahura nga Serbia, paraqesin një sfidë dhe një provokim serioz për IPVK-në dhe për UNMIK-un. Ato, me veprimet e veta po destabilizojnë një pjesë të vendit, po e promovojnë konceptin e ndarjes së territorit të Kosovës në baza etnike.

Strukturat paralele në Kosovë po veprojnë në të gjitha format e jetës, veçanërisht në: zbatimin e legjislacionit të Serbisë në veriun e Kosovës dhe në enklavat sebe; veprimi i shërbimeve sekrete serbe dhe pjesëmarrja e tyre aktive në të gjitha format e krimit të organizuar në Kosovë; funksionimi i administratës dhe i sistemit gjuqësor paralel serb në territoret ku jeton pakica serbe; funksionimi paralel i institucioneve arsimore, shëndetësore, kulturore dhe institucionet e tjera.

Veprimi i këtyre institucioneve përkrahet dhe financohet nga buxheti i Serbisë.

Përkundër politikës konstruktive të institucioneve të Kosovës që i ofrohet pakicës serbe për tu integruar brenda insticioneve kosovare, ata hezitojnë dhe e kundërshtojnë integrimin e tyre në këto struktura. Pakica serbe është e instrumentalizuar nga politike e Beogradit me qëllim të pengimit të zhvillimeve të proceseve demokratike në Kosovë.

Në anën tjetër institucionet e Kosovës dhe UNMIK-u ende nuk e kanë hartuar një strategji vepruese për shpërbërjen e strukturave paralele në Kosovë.

Duke u nisur nga rreziku që paraqet funksionimi i strukturave paralele serbe në Kosovë, Kuvendi i Kosovës duhet t'i ndërmarrë këto veprime:

1. Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë një raport nga PSSH-ja dhe nga përfaqësuesit e shtyllës së parë dhe të dytë të UNMIK-ut dhe KFOR-i se cilat masa janë duke i ndërmarrë për shpërbërjen e veprimit të strukturave paralele serbe në Kosovë.

2. Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga përfaqësuesi i UNMIK-ut që në përmbushjen e standardeve për Kosovën të parashihet edhe zhbërja e të gjitha strukturave paralele në tërë territorin e Kosovës.

3. Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë një rezolutë të veçantë dhe t'ia drejtojë KS të OKB-së, me të cilën obligohet UNMIK-u dhe KFORI-në për zhbërjen e strukturave paralele në Kosovë.

Diskutimi lidhur me veprimin e strukturave paralele serbe në Kosovë nuk duhet të përfundojë në seancën e sotme, por ai duhet të vazhdojë në një seancë të veçantë, që duhet të përgatitet më mirë, në të cilën do të ftohen përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të UNMIK-ut dhe të përgjegjësve për çështjet e sigurisë.

Fatmir Sejdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, theksoi se pas katër vjet e gjysëm të vendosjes së administratës ndërkombëtare dhe krijimit të institucioneve vendore, të dalura nga vota e lirë e qytetarëve, ende po ekzistojnë dhe veprojnë strukturat paralele në Kosovë, të nxitura dhe të krijuara nga Serbia. Këto struktura po bëjnë

diversion të vazhdueshëm me qëllim të shkatrrimit të së tashmes dhe të ardhmës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Përkundër përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare, këto struktura ende lirësheëm veprojnë dhe po gjenerojnë pasoja negative për situatën e përgjithshme në Kosovë. Veprimi i tyre më i theksuar shtë në këto fusha: në sistemin e gjyqësië; në institucionet e sigurisë, si "rojat e urës" në Mitrovicë, këtë e konfirmon vetë shefi i zbulimit të ushtrisë së SMZ; në administratën e shërbimeve publike dhe të qeverisjes lokale; në sistemin e arsimit të të gjitha niveleve; në shëndetësi; në fushën e telekomunikacionit etj. Veprimin e strukturave paralele serbe në Kosovë e konfirmon edhe raporti i OSBE-së për vitin 2003.

UNMIK-u nuk ka qenë i vendosur në shpërbërjen e këtyre strukturave, por e ka toleruar ekzistimin e tyre. Veprimi i tyre është lejuar edhe përmes stimulimit të dyfishtë material, posaçërisht në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. UNMIK-u ka krijuar partneritet me strukturat paralele, sidomos në fushën e administratës lokale dhe të gjyqësisë, duke i njohur vendimet e tyre. Janë toleruar veprimet e Serbisë në inkurajimin dhe krijimin e këtyre strukturave, sidomos në fushën e gjyqësisë dhe të sigurisë. Marrëveshja Hakerup-Çoviq e ka inkurajuar veprimin e këtyre strukturave. Administrata e UNMIK-ut i kushtëzon qytarët e Kosovës të sigurojnë dokumente identifikimi të lëshuara nga këto struktura me ratin e pajisjes me dokumente të udhëtimit. Disa anëtare të bashkësisë ndërkombëtare ende nuk i njohin dokumentet e udhëtimit të qytetarëve të Kosovës, të lëshuara nga vetë UNMIK-u.

Bashkësia ndërkombëtare duhet ta shtojë presionin e vet për zhbërjen e strukturave paralele serbe në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës duhet ta inkurajojë dhe mbështesë fuqishëm Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera vendore për zhbërjen e strukturave paralele dhe për shtrirjen e përgjegjesive të tyre në tërë territorin e Kosovës.

Ramush Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, theksoi se çështja e parë që duhet bërë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare në Kosovë është identifikimi i strukturave paralele serbe në Kosovë. Ku ekzistojnë ato? Si veprojnë dhe cilat janë efektet negative të tyre?

Me një angazhim të përbashkët të institucioneve vendore dhe të atyre ndërkombëtare në planin për standardet për Kosovën duhet të parashihet edhe zhbërja e strukturave paralele në Kosovë.

Kuvendi mund ta formojë një komision të veçantë, në bashkëpunim me UNMIK-un, KFOR-in, policinë e UNMIK-ut dhe me shërbime të tjera që kanë të dhëna siç janë OSBE-në dhe ASGJ-ia për të pasur një qëndrim të përbashkët për zhbërjen e strukturave paralele në Kosovë.

Të hartohet një plan i përbashkët që deri në mesin e vitit 2005 të përfundojë zhbërja e këtyre strukturave.

Kuvendi duhet ta nxjerrë një rezolutë për zhbërjen e strukturave paralele në Kosovë.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta lidhur me veprimin e strukturave paralele në Kosovë i dhanë edhe deputetët: Nekibe Kelmendi, Ismajl Kurteshi, Muhamed Kelmendi, Naim Maloku, Bajram Kosumi, Sabri Hamiti, Smajl Latifaj, Hasan Metaj, Mahir Jakhillar, Sylejman Çerkezi dhe Ramadan Kelmendi.

Pas diskutimeve të zhvilluara lidhur me veprimin e strukturave paralele në Kosovë, Kuvendi nxori këtë:

Përfundim

Kryetarët e grupeve parlamentare, në bazë të diskutimeve të zhvilluara gjatë kësaj seance, duhet ta hartojnë një Projektrezolutë lidhur me veprimin e strukturave paralele në Kosovë dhe t'ia paraqesin Kuvendit për miratim.

8. Përgjigjet e ministrave pyetjeve të deputetëve.

Ministri Ali Sadriu iu kishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit Ismajl Krteshi lidhur me financimin e projektit për ordinancat private në Ferizaj.

Deputeti Ismajl Kurteshi tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen me shkrim të ministrit Sadriu dhe e kërkon përgjigjen gojore nga ai.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 16:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI